



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 71, datë 22.04.2022

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa "a" të ligjit Nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, në Vendimin Nr.64, datë 15.04.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë "Për miratimin e rregullores "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve" i ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. **Zonja Elidjana Kasa**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, të caktohet përkohësisht si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Zonja Elidjana Kasa do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, nga data 25.04.2022 - 24.07.2022.
3. Të njoftohen për këtë vendim zonja Elidjana Kasa, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
4. Gjatë periudhës së caktimit të përkohshëm zonja Elidjana Kasa do të përfitojë shtesë mbi pagën referuese bazë, në masën 40%.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 22.04.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
SOKOL STOJANI

ANËTAR  
ELOIDA GOXHI

ANËTAR  
ZEQIR HODA

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETAR  
TARTAR BAZAJ

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

ANËTAR  
LUDOVIK DODAJ

ANËTAR  
MIRELA BOGDANI

